

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**  
**KOLEGJI I APELIT TË (AKP) AGJENCISE KOSOVARE TR PRONAVE**  
**ŽALBENO VEĆE (KAI)KOSOVSKE AGENCIJE ZA IMOVINU**

**GSK-KPA-A-110/2014**

Prishtinë,  
19 Tetor 2016

Në çështjen juridike të:

**N. D. në emër të vëllaut M. D.**

**Pala ankuese**

***Kundër:***

***A. G.***

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga, Sylejman Nuredini Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) nr KPCC/D/R/231/2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA25072), i datës 13 Mars 2014, (në tekstin e mëtejme: vendimi i KKPK-së) pas shqyrtimit të mbajtur më 19 Tetor 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

**Hidhet poshtë si e palejueshme ankesa e M. D. e ushtruar përmes N.D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/231/2014, të datës 13 Mars 2014, për sa i përket lëndës nr KPA25072.**

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 14 Shkurt 2007 M. M.D., (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon vërtetimin e pronësisë mbi podrumin/banesën me sipërfaqe prej 70 m<sup>2</sup> që ndodhet në rrugën “Naselje Braće Aksić” blloku i dytë Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm (prona e kërkuar). Ai pretendon se pronën e kërkuar e kishte adaptuar nga pjesa e sipërfaqes së podrumeve që ishin në shfrytëzim të përbashkët i të gjithë banuesve të ndërtesës duke marrë pëlqimin e tyre.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar dokumentet në vijim:
  - Aktvendim 110 Nr. 464-08-12339/93 datë 5 Maj 1993 që i referohet lejitimit të privatizimit të një banese tjetër
  - Kontratë shfrytëzimi Nr. 1194/44 me numër legalizimi Ov.Br. 4403/93 datë 17 Qershor 1993 e lidhur në mes Ndërmarrjes Publike Banesore të Prishtinës dhe M. D. (babait të paraqitësit të kërkesës) që i referohet pjesmarrjes së individve në mirmbajtjen e pjesëve të posaçme të ndërtesës lidhur me shfrytëzuesit e banesës Nr. 8, hyrja IV Lagja Aktash 3 Blloku II me sipërfaqe pre 33.09 m<sup>2</sup>.
  - Një hartë të vizatuar me dorë ku ndodhej prona e lëkuar;
3. Më 24 Prill 2008, Ekipi i AKP-së ka bërë identifikimin e pronës së kërkuar . Nga njoftimi është gjetur se prona e kërkuar është një bodrum i adaptuar për banim, dhe se në momentin e vizitës së pronës ajo ishte e zënë nga A. G. (pala përgjegjëse).
4. Ai ishte i pranishëm dhe ka nënshkruar deklaratën e palës përgjegjëse në kërkesë duke deklaruar se pretendon të drejtë ligjore për pronën e kërkuar.
5. Për të mbështetur pretendimet e veta pala përgjegjëse paraqiti :
  - Kontratë shitblerje pa datë e lidhur mes A. C. dhe T. G., vajza e palës përgjegjëse. Kontrata nuk është e vërtetuar në gjykatë.
  - Letërnjoftim me datë dhe numër të palexueshëm.

6. Më 13 Mars 2014, KKPK-ja përmes vendimit të vet KPCC/D/R/2231/2014, e ka refuzuar kërkesën me arsyetimin (paragrafin 47) se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të deshmoi ndonjë të drejtë pronësore në pronën e kërkuar dhe se Sekretaria ekzekutive e AKP-së nuk ka mundur të siguroi sipas detyrës zyrtare asnjë dëshmi në favor të pretendimeve të paraqitësit të kërkesës.
7. Vendimi i KKPK-së është pranuar nga paraqitësi i kërkesës më 15 maj 2014 dhe me 2 Qershor 2014 N. D., vëllai i paraqitësit të kërkesës(më tej pala ankuese) ka paraqitur ankesë në vendimin e Komisionit
8. Pala përgjegjëse e ka pranuar ankesën dhe është përgjigjur me 25 Qershor 2014.
9. Me 15 Qershor 2016 Gjykata Supreme i urdhëroi palës ankuese që të sjellë dëshmi se ai mund të paraqesë ankesë në emër të vllaut dhe të përgjigjet në pretendimet e palës përgjegjëse të dhëna në përgjigje të ankesës por ai nuk është përgjigjur

### **Pretendimet e palëve**

10. Pala ankuese pretendon se prona ka qenë e vëllait të tij dhe se ata janë zhvendosur në Krushevc të Serbisë por se prona është e zënë dhe ata nuk mund ta shfrytëzojnë. Ankesës i bashkëngjiti vetëm kopjen e letërnjoftimit
11. Pala përgjegjëse e kundështoi pretendimin e palës ankuese duke pohuar se ankesa nuk i përmbush kushtet e parapara dhe është e paqartë, duke vënë në dukje se ai nuk ka kapacitete të palës në procedurë. Ai propozoi Gjykatës që ta hedhte ankesën dhe ta konfirmoi vendimin e KKPK-së.

### **Arsyetimi ligjor**

#### *Pranueshmëria e ankesës*

12. Gjykata vëren se ankesa është e paraqitur nga pala ankuese duke veprura në emër të vëllait të tij por pa një autorizim valid. Për këtë arsye ankesa është e palejueshme.
13. Gjykata gjeti se ankesa është e palejueshme referuar nenit 186.3 e 186.3 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) ( më tej LPK) ku parashihet se “Ankesa është e palejueshme po që se e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, ....”

14. Po ashtu referuar dispozitave të nenit 5 të Urdhëresës administrative nr. 2007/05 për zbatimin e Rregullores UNMIK/REG/2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale paraqitësi i kërkesës nuk i përmbush kriteret. Kjo nga se paraqitësi i kërkesës nuk e ka cilësinë e palës as që ka autorizim për ta përfaqësuar titullarin përkatësisht vëllain e tij. Ai nuk është anëtarë i ngushtë i familjes sipas dispozitës së nenit 1 paragr.12 të Urdhëresës, që ka të bëjë me përkufizimin si “*Anëtar i familjes*” nënkupton *bashkëshorti apo bashkëshortja, fëmijët (e lindur në martesë apo të birësuar) dhe personat e tjerë, të cilët është i obliguar t’i përkrabë poseduesi i të drejtës në pronë në përputhje me ligjin në fuqi, apo personat që janë të obliguar ta përkrabin poseduesin e të drejtës në pronë në përputhje me ligjin në fuqi, .....*”
15. Si rrjedhojë, gjykata nuk gjen asnjë arsye se pse pala ankuese duhet të ketë të drejtë të paraqes ankesë, si palë për interesat e veta dhe as si përfaqësues i paraqitësit të kërkesës për mungesë të autorizimit valid.
16. Gjukata duke e konsideruar ankesën si të palejueshme nuk shqyrtoi meritat e por gjeti se Vendimi i Komisionit është nxjerrë në përputhje me ligjin procedural dhe material.
17. Në bazë të mësipërmes dhe në pajtim me nenin 13.3 nën b, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, gjykata vendosi si në dispozitiv.

### **Këshillë juridike**

18. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it**